

L I G J
Nr.9466, datë 23.1.2006

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE KOMUNITETIT EUROPIAN PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE QË QËNDROJNË
PA AUTORIZIM”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 shkronja “b” të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për ripranimin e personave që qëndrojnë pa autorizim”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.4766, datë 8.2.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE
**NDËRMJET KOMUNITETIT EUROPIAN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR
RIPRANIMIN E PERSONAVE QË QËNDROJNË PA AUTORIZIM**

Palët e Larta Kontraktuese, Komuniteti Europian, në vijim i përkufizuar si “Komuniteti”, dhe Republika e Shqipërisë, në vijim e përkufizuar si “Shqipëria”,
të vendosura për të forcuar bashkëpunimin e tyre me qëllimin për të luftuar emigracionin e paligjshëm në mënyrë më efektive;

duke dëshiruar të përcaktojnë, me anë të kësaj Marrëveshjeje dhe mbi bazën e reciprocitetit, procedura të shpejta dhe të efektshme për identifikimin dhe kthimin e sigurt dhe të rregullt të personave të cilët nuk përmbushin ose nuk i përmbushin më tej kushtet për të hyrë, për të qëndruar ose për të banuar në territoret e Shqipërisë ose të njërit prej shteteve anëtare të Bashkimit Europian, si dhe për të lehtësuar kalimin transit të këtyre personave në një frymë bashkëpunimi;

duke theksuar që kjo Marrëveshje nuk paragjykon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Komunitetit, të shteteve anëtare të Bashkimit Europian dhe të Shqipërisë, të cilat burojnë nga e drejta ndërkombëtare dhe, në veçanti, nga Konventa Europiane e 4 nëntorit 1950 për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, nga Konventa Europiane e 28 korrikut 1951 dhe protokollin e 31 janarit 1967 për statusin e refugjatëve, dhe nga instrumentet ndërkombëtare për ekstradimin;

duke marrë parasysh që dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, të cilat përputhen me fushën e zbatimit të kreut IV të Traktatit Themelues të Komunitetit Europian, nuk zbatohen për Mbretërinë e Danimarkës, në përputhje me protokollin mbi pozicionin e Danimarkës bashkëngjitur traktatit mbi Bashkimin Europian dhe Traktatit Themelues të Komunitetit Europian,

kanë rënë dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Përkufizimet

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje:

a) "Shtet anëtar" nënkupton çdo shtet anëtar të Bashkimit European, me përjashtim të Mbretërisë së Danimarkës.

b) "Shtetas i një shteti anëtar" nënkupton çdo person që ka shtetësinë e një shteti anëtar, siç përkufizohet për qëllim të Komunitetit.

c) "Shtetas i Shqipërisë" nënkupton çdo person që ka shtetësinë shqiptare.

d) "Shtetas i një vendi të tretë" nënkupton çdo person që ka shtetësi të ndryshme nga ajo shqiptare apo ndonjë prej shteteve anëtare.

e) "Person pa shtetësi" nënkupton çdo person që nuk ka shtetësi.

f) "Lejeqëndrimi" nënkupton një leje të çdo lloji të lëshuar nga Shqipëria ose nga ndonjë prej shteteve anëtare që e lejon një person të qëndrojë në territorin e saj/tij. Këtu nuk përfshihen lejet e përkohshme për të qëndruar në territorin e vendit në lidhje me shqyrtimin e një kërkesë për azil ose për leje qëndrimi.

g) "Vizë" nënkupton një autorizim të lëshuar apo një vendim të marrë nga Shqipëria ose nga një prej shteteve anëtare, i cili kërkohet për të hyrë ose për të kaluar transit në territorin e tij. Këtu nuk përfshihet viza e transitit në aeroport.

SEKSIONI 1 DETYRIMET PËR RIPRANIM NGA SHQIPËRIA

Neni 2

Ripranimi i shtetasve të vet

1. Shqipëria ripranon, me kërkesën e një shteti anëtar dhe pa formalitete të tjera, përveç atyre të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të gjithë personat të cilët nuk plotësojnë ose nuk plotësojnë më tej, kushtet që janë në fuqi për hyrjen, qëndrimin ose banimin në territorin e shtetit anëtar kërkues, me kusht që të provohet ose të pranohet në mënyrë të vlefshme në bazë të sigurimit të provave në dukje se ata janë shtetas të Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe për personat të cilëve u është hequr ose që kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare që nga hyrja në shtetin anëtar, përveç rasteve kur këtyre personave u është premtuar dhënia e shtetësisë nga ai shtet anëtar.

2. Shqipëria, sipas nevojës dhe pa vonesë, pajis personin, për ripranimin e të cilit është rënë dakord, me dokumente udhëtimi që duhen për kthimin e tij/saj, të vlefshme për një periudhë të paktën 6-mujore. Nëse për arsye ligjore ose faktike, personi në fjalë nuk mund të transferohet brenda periudhës së vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit të lëshuar fillimisht, Shqipëria, brenda 14 ditëve kalendarike, shtyn vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit ose, nëse është nevoja, lëshon një dokument të ri udhëtimi me të njëjtën periudhë vlefshmërie. Nëse Shqipëria, brenda 14 ditëve kalendarike, nuk e ka lëshuar dokumentin e udhëtimit, nuk e ka shtyrë vlefshmërinë e tij apo, nëse ka qenë e nevojshme, nuk e ka rinovuar atë, pranohet përdorimi i dokumentit standard të udhëtimit të Bashkimit European për qëllime të dëbimit.¹

Neni 3

Ripranimi i shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi

1. Shqipëria ripranon, me kërkesë të një shteti anëtar dhe pa formalitete të mëtijshme, veç atyre të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të gjithë shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi, të cilët nuk plotësojnë ose nuk i plotësojnë më tej kushtet në fuqi për hyrjen, qëndrimin ose banimin në territorin e shtetit anëtar kërkues, me kusht që të provohet ose të pranohet në mënyrë të vlefshme në bazë të sigurimit të provave në dukje se ata persona:

a) kanë, ose në kohën kur kanë hyrë kishin vizë ose lejeqëndrimi të lëshuar nga Shoqëria; ose

b) kanë hyrë në territorin e shteteve anëtare, pasi kanë qëndruar në, ose kanë kaluar transit nëpër, territorin e Shqipërisë.

2. Detyrimi për ripranim në paragrafin 1 nuk zbatohet nëse:

¹ Rekomandimi i Këshillit i datës 30 nëntor 1994 në lidhje me përdorimin e një dokumenti standard udhëtimi për dëbimin e shtetasve të vendeve të treta. (OJ C 274, datë 19.9.1996, faqe 18.)

a) shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi ka kaluar transit nëpër një aeroport ndërkombëtar të Shqipërisë; ose

b) shteti anëtar kërkues i ka lëshuar shtetasit të vendit të tretë ose personit pa shtetësi një vizë ose lejeqëndrimi para ose pas hyrjes në territorin e tij, përveç rastit kur:

- ai person zotëron një vizë ose lejeqëndrimi lëshuar nga Shqipëria, që ka një periudhë vlefshmërie më të gjatë; ose

- viza ose leja e qëndrimit e lëshuar nga shteti anëtar kërkues është marrë duke përdorur dokumente të rreme apo të falsifikuara.

3. Shqipëria, sipas nevojës dhe pa vonesë, pajis personin, për ripranimin e të cilit është rënë dakord, me dokumente udhëtimi që duhen për kthimin e tij/saj të vlefshme për një periudhë të paktën 6-mujore. Nëse, për arsye ligjore ose faktike, personi në fjalë nuk mund të transferohet brenda periudhës së vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit të lëshuar fillimisht, Shqipëria, brenda 14 ditëve kalendarike, shtyn vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit ose, nëse është nevoja, lëshon një dokument të ri udhëtimi me të njëjtën periudhë vlefshmërie. Nëse Shqipëria, brenda 14 ditëve kalendarike, nuk e ka lëshuar dokumentin e udhëtimit, nuk ka shtyrë vlefshmërinë e tij apo, nëse ka qenë e nevojshme, nuk e ka rinovuar atë, pranohet përdorimi i dokumentit standard të udhëtimit të Bashkimit Europian për qëllime të dëbimit².

SEKSIONI II

DETYRIMET PËR RIPRANIMIN NGA KOMUNITETI

Neni 4

Ripranimi i shtetasve të vet

1. Një shtet anëtar ripranon, me kërkesë të Shqipërisë dhe pa formalitete të tjera, përveç atyre të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të gjithë personat të cilët nuk plotësojnë ose që nuk plotësojnë më tej kushtet për hyrjen, qëndrimin ose banimin në territorin e Shqipërisë, me kusht që të provohet ose të pranohet në mënyrë të vlefshme në bazë të sigurimit të provave në dukje se ata janë shtetas të atij shteti anëtar.

E njëjta dispozitë zbatohet për personat të cilëve u është hequr ose kanë hequr dorë nga shtetësia e shtetit anëtar që nga hyrja në territorin e Shqipërisë, me përjashtim kur këtyre personave u është premtuar dhënia e shtetësisë nga Shqipëria.

2. Një shtet anëtar, sipas nevojës dhe pa vonesë, pajis personin, për ripranimin e të cilit është rënë dakord, me dokumente udhëtimi që duhen për kthimin e tij/saj, të vlefshme për një periudhë të paktën 6-mujore. Nëse, për arsye ligjore ose faktike, personi në fjalë nuk mund të transferohet brenda periudhës së vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit të lëshuar fillimisht, shteti anëtar në fjalë, brenda 14 ditëve kalendarike shtyn vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit ose, nëse është nevoja, lëshon një dokument të ri udhëtimi me të njëjtën periudhë vlefshmërie. Nëse shteti anëtar në fjalë, brenda 14 ditëve kalendarike, nuk e ka lëshuar dokumentin e udhëtimit, nuk ka shtyrë vlefshmërinë e tij apo, nëse ka qenë e nevojshme, nuk e ka rinovuar atë, pranohet përdorimi i certifikatës shqiptare për qëllime të dëbimit².

Neni 5

Ripranimi i shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi

1. Një shtet anëtar ripranon, me kërkesë të Shqipërisë dhe pa formalitete të mëtejshme, veç atyre të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të gjithë shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi, të cilët nuk plotësojnë ose nuk plotësojnë më tej kushtet që janë në fuqi për hyrjen, qëndrimin ose banimin në territorin e Shqipërisë, me kusht që të provohet ose të pranohet në mënyrë të vlefshme në bazë të sigurimit të provave në dukje se këta persona:

a) kanë, ose në kohën kur kanë hyrë kanë pasur vizë se lejeqëndrimi të lëshuar nga shteti

² Vërtetuar në instruksionin nr.553 të 19 nëntorit 2003 të zëvendësministrit të Punëve të Jashtme për dhënien e lejeqëndrimit (laissez-passer) nga përfaqësitë shqiptare për kthimin në Shqipëri.

anëtar i kërkuar; ose

b) kanë hyrë në territorin e Shqipërisë pasi kanë qëndruar në ose kanë kaluar transit nëpër territorin e shtetit anëtar të kërkuar.

2. Detyrimi për ripranim në paragrafin 1 nuk zbatohet nëse:

a) shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi ka kaluar vetëm transit nëpër një aeroport ndërkombëtar të shtetit anëtar të kërkuar; ose

b) Shqipëria i ka dhënë shtetasit të vendit të tretë ose personit pa shtetësi një vizë ose lejeqëndrimi para ose pas hyrjes në territorin e tij, përveç rastit kur:

- ai person zotëron një vizë ose lejeqëndrimi lëshuar nga shteti anëtar i kërkuar, që ka një periudhë vlefshmërie më të gjatë; ose

- viza ose leja e qëndrimit e lëshuar nga Shqipëria është marrë duke përdorur dokumente të rreme apo të falsifikuara.

3. Detyrimi për ripranimin në paragrafin 1 i përket shtetit anëtar që ka lëshuar një vizë ose lejeqëndrimi. Nëse dy ose më shumë shtete anëtare kanë lëshuar vizë ose lejeqëndrimi, detyrimi për ripranim i paragrafit 1 i përket shtetit anëtar që ka lëshuar dokumentin me periudhë vlefshmërie më të gjatë ose, nëse njërit apo disave prej tyre u ka mbaruar afati, dokumentin që është ende i vlefshëm. Nëse të gjitha dokumenteve tashmë u ka mbaruar vlefshmëria, detyrimi për ripranim i paragrafit 1 i përket shtetit anëtar që ka lëshuar dokumentin me afatin më të vonë të vlefshmërisë. Nëse nuk paraqiten dokumente të tilla, detyrimi për ripranimin e paragrafit 1 i përket shtetit anëtar ku është bërë dalja e fundit.

4. Një shtet anëtar, sipas nevojës dhe pa vonesë, pajis personin, për ripranimin e të cilit është rënë dakord, me dokumente udhëtimi që duhen për kthimin e tij/saj, të vlefshme për një periudhë të paktën 6-mujore. Nëse, për arsye ligjore ose faktike, personi në fjalë nuk mund të transferohet brenda periudhës të vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit të lëshuar fillimisht, shteti anëtar në fjalë, brenda 14 ditëve kalendarike, shtyn vlefshmërinë e dokumentit të udhëtimit ose, nëse është nevoja, lëshon një dokument të ri me të njëjtën periudhë vlefshmërie. Nëse shteti anëtar, brenda 14 ditëve kalendarike nuk e ka lëshuar dokumentin e udhëtimit, nuk ka shtyrë vlefshmërinë e tij apo, nëse ka qenë e nevojshme, nuk e ka rinovuar atë, pranohet përdorimi i certifikatës shqiptare për qëllime të dëbimit.

SEKSIONI III PROCEDURA E RIPRANIMIT

Neni 6

Parimi

1. Sipas paragrafit 2, çdo transferim i një personi që do të ripranohet mbi bazën e njërit prej detyrimeve që përmbajnë nenet 2 deri 5 kërkon paraqitjen e një kërkesë për ripranim tek autoriteti kompetent i shtetit të kërkuar.

2. Kërkesa për ripranim mund të zëvendësohet me një komunikim me shkrim pranë autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar brenda një periudhe kohe të arsyeshme përpara kthimit të personit në fjalë, nëse personi që do të ripranohet zotëron një dokument udhëtimi të vlefshëm dhe, aty ku është e zbatueshme, një vizë ose lejeqëndrimi të vlefshme të shtetit të kërkuar.

Neni 7

Kërkesa për ripranim

1. Për aq sa është e mundur, kërkesa për ripranim duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) të dhënat personale të personit që do të ripranohet (p.sh. emri, mbiemri, data e lindjes dhe, aty ku është e mundur, vendi i lindjes, emri i babait, emri i nënës dhe vendbanimi i fundit);

b) përshkrim i mënyrave me anë të të cilave do të sigurohen provat në dukje, për shtetësinë, transitin, kushtet për ripranimin e shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi dhe hyrjen dhe qëndrimin e paligjshëm.

2. Për aq sa është e mundur, kërkesa për ripranim duhet të përmbajë gjithashtu informacionin e mëposhtëm:

a) një deklaratë ku tregohet që personi që do të transferohet mund të ketë nevojë për ndihmë apo kujdes, me kusht që personi në fjalë të ketë shprehur pranimin e tij për këtë deklaratë;

b) çdo masë tjetër mbrojtjeje apo sigurie që mund të jetë e nevojshme për rastin e veçantë të transferimit.

3. Një formular i përbashkët që do të përdoret për kërkesat për ripranim, është bashkëngjitur si aneksi 5 i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

Mjetet e provës në lidhje me shtetësinë

1. Prova e shtetësisë sipas nenit 2 (1) dhe nenit 4 (1) mund të jepet nëpërmjet ndonjërit prej dokumenteve të listuara në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje, edhe nëse periudha e vlefshmërisë së tyre ka mbaruar. Nëse paraqiten dokumente të tilla, shtetet anëtare dhe Shqipëria njohin reciprokisht shtetësinë pa qenë nevoja për hetim të mëtejshëm. Prova e shtetësisë nuk mund të jepet nëpërmjet dokumenteve të rreme.

2. Provat në dukje sipas nenit 2 (1) dhe nenit 4 (1) mund të jepen veçanërisht nëpërmjet dokumenteve të shënuara në aneksin 2 të kësaj Marrëveshjeje, edhe nëse periudha e tyre e vlefshmërisë ka mbaruar. Nëse paraqiten dokumente të tilla, shtetet anëtare dhe Shqipëria pranojnë shtetësinë, me përjashtim të rastit kur mund të vërtetohet të kundërtën. Provat në dukje në lidhje me shtetësinë nuk mund të jepen nëpërmjet dokumenteve të rreme.

3. Nëse nuk mund të paraqitet asnjë nga dokumentet e shënuara në anekset 1 ose 2, përfaqësitë kompetente diplomatike dhe konsullore të Shqipërisë ose të shtetit anëtar në fjalë marrin masat, me paraqitjen e një kërkesë, për të intervistuar pa vonesë personin që do të ripranohet me qëllim që të përcaktojnë shtetësinë e tij/saj.

Neni 9

Mjetet e provës në lidhje me shtetasit e vendeve të treta dhe personat pa shtetësi

1. Prova e kushteve për ripranimin e shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi, përcaktuar në nenin 3 (1) dhe në nenin 5 (1), do të jepet veçanërisht nëpërmjet njërit prej mjeteve të provës të listuara në aneksin 3 të kësaj Marrëveshjeje; ajo nuk mund të jepet nëpërmjet dokumenteve të rreme. Çdo provë e tillë njihet reciprokisht nga shtetet anëtare dhe nga Shqipëria pa qenë nevoja për hetim të mëtejshëm.

2. Provat në dukje për kushtet e ripranimit të shtetasve të vendeve të treta dhe të personave pa shtetësi, përcaktuar në nenin 3 (1) dhe nenin 5 (1), jepen veçanërisht nëpërmjet njërit prej mjeteve të provës të shënuara në aneksin 4 të kësaj Marrëveshjeje; ato nuk mund të jepen nëpërmjet dokumenteve të rreme. Nëse paraqiten dokumente të tilla, shtetet anëtare dhe Shqipëria vlerësojnë përcaktimin e kushteve, përveç rastit kur mund të vërtetohet të kundërtën.

3. Paligjshmëria e hyrjes, qëndrimit apo banimit përcaktohet me anën e dokumenteve të udhëtimit të personit në fjalë në të cilat mungon viza apo leja e qëndrimit në territorin e shtetit që bën kërkesën. Një deklaratë e shtetit që bën kërkesën që personi në fjalë është gjetur pa dokumentet e nevojshme të udhëtimit, vizë apo lejeqëndrimi paraqitet si provë në dukje për hyrjen, qëndrimin ose banimin e paligjshëm.

Neni 10

Afatet kohore

1. Kërkesa për ripranim duhet të paraqitet pranë autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar brenda një periudhe maksimale njëvjeçare nga koha kur autoriteti kompetent i shtetit kërkuar merr dijeni që një shtetas i një vendi të tretë apo një person pa shtetësi nuk plotëson ose nuk i plotëson më tej kushtet që janë në fuqi për hyrjen, qëndrimin ose banimin. Kur ka pengesa ligjore ose faktike që kërkesa të paraqitet në kohë, afati kohor, me kërkesë të shtetit kërkuar, do të shtyhet, por vetëm derisa

pengesa të mos ekzistojë më.

2. Një kërkesë për ripranim duhet t'i kthehet përgjigje pa vonesë të panevojshme, dhe në çdo rast brenda një periudhe maksimale prej 14 ditësh kalendarike; për mospranimin e një kërkesë për ripranim do të jepen arsye. Afati kohor fillon nga data e marrjes së kërkesës për ripranim. Nëse brenda këtij afati kohor nuk ka përgjigje, kjo do të konsiderohet sikur kërkesa është pranuar.

3. Pasi është pranuar kërkesa apo kur është e nevojshme, pas mbarimit të periudhës prej 14 ditësh kalendarike, personi në fjalë transferohet pa vonesë, dhe e shumta, brenda 3 muajsh. Pas kërkesës nga shteti kërkues ky afat kohor mund të zgjatet sa koha që duhet për të kaluar pengesat ligjore apo praktike.

Neni 11

Modalitetet e transferimit dhe mënyrat e transportimit

1. Para kthimit të një personi, autoritetet kompetente të Shqipërisë dhe të shtetit anëtar në fjalë bien në ujdë që më parë me shkrim në lidhje me datën e transferimit, vendin e hyrjes, shoqërimin e mundshëm dhe të dhëna të tjera që kanë lidhje me transferimin.

2. Nuk ndalohej asnjë mjet transporti, qoftë nga ajri, toka apo deti. Kthimi në rrugë ajrore nuk do të kufizohet në përdorimin e shoqërive të transportit ajror të Shqipërisë ose të shteteve anëtare dhe mund të bëhet duke përdorur avionë linjë apo charter. Në rastin e kthimeve të shoqëruara, këta shoqërues nuk kufizohen vetëm në persona të autorizuar të shtetit që bënë kërkesën, me kusht që të jenë persona të autorizuar nga Shqipëria ose nga ndonjë shtet anëtar.

Neni 12

Ripranimi i gabuar

Shqipëria merr mbarsht pa vonesë çdo person të ripranuar nga një shtet anëtar, dhe një shtet anëtar merr mbarsht pa vonesë çdo person të ripranuar nga Shqipëria, nëse vërtetohet, brenda një periudhe tremujore pas transferimit të personit në fjalë, që kërkesat e vendosura në nenet 2 dhe 5 të kësaj Marrëveshjeje nuk plotësohen. Në këto raste, autoritetet kompetente të Shqipërisë dhe të shtetit anëtar në fjalë shkëmbejnë gjithashtu të gjithë informacionin e disponueshëm që ka të bëjë me identitetin aktual, shtetësinë ose itinerarin e transitimit të personit që do të merret mbarsht.

SEKSIONI IV

OPERACIONET TRANSIT

Neni 13

Parimet

1. Shtetet anëtare dhe Shqipëria kufizojnë kalimin transit të shtetasve të vendeve të treta apo të personave pa shtetësi në raste kur këta persona nuk mund të shkojnë direkt në shtetin për ku janë nisur.

2. Shqipëria lejon kalimin transit të shtetasve të vendeve të treta ose të personave pa shtetësi nëse një shtet anëtar e kërkon një gjë të tillë, dhe një shtet anëtar autorizon kalimin transit të shtetasve të vendeve të treta apo të personave pa shtetësi, nëse Shqipëria e kërkon një gjë të tillë, nëse sigurohet udhëtimi i mëtejshëm transit në shtete të tjera të mundshme dhe ripranimi nga shteti i destinacionit.

3. Transiti mund të refuzohet nga Shqipëria ose nga një shtet anëtar:

a) nëse shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi rrezikon realisht të bëhet subjekt i torturave apo i trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor apo poshtërues, i dënimit me vdekje, ose i përndjekjes për shkak të racës, fesë, kombësisë, pjesëmarrjes në një grup shoqëror apo një bindje politike të veçantë, në shtetin për ku është drejtuar apo në një shtet tjetër ku do të kalojë transit;

b) nëse shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi do t'i nënshtrohet ndjekjes ose sanksioneve penale në shtetin e kërkuar ose në një shtet tjetër ku do të kalojë transit;

c) për arsye të shëndetit publik, sigurisë së brendshme, rendit publik ose interesave të tjera të shtetit të kërkuar.

4. Shqipëria ose një shtet anëtar mund të anulojë çdo leje të dhënë nëse dalin në dritë më vonë rrethanat e përmendura në paragrafin 3 ose nëse udhëtimi i mëtejshëm në shtete të mundshme për kalim transit ose ripranimi nga ana e shtetit ku personi është drejtuar nuk është më i sigurt. Në këtë rast shteti kërkuar e merr sërish shtetasin e vendit të tretë ose personin pa shtetësi, sipas nevojës dhe pa vonesë.

Neni 14

Procedura e kalimit transit

1. Një kërkesë për operacionet e kalimit transit duhet t'i paraqitet autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar me shkrim dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) llojin e transitit (me rrugë ajrore, tokësore apo detare), shtetet e tjera të mundshme për transit dhe destinacioni përfundimtar;

b) të dhënat e veçanta të personit në fjalë (p.sh. emri, mbiemri, emri i vajzërisë, emra të tjerë që përdor ose pseudonime, data e lindjes, seksi dhe – aty ku është e mundur – vendi i lindjes, kombësia, gjuha, lloji dhe numri i dokumentit të udhëtimit);

c) vendi i parashikuar i hyrjes, koha e transferimit dhe përdorimi i mundshëm i shoqëruesve;

d) një deklaratë që sipas mendimit të shtetit kërkuar përmbushen kushtet lidhur me nenin 13 (2) dhe që nuk ka arsye për mospranim sipas nenit 13 (3).

Një formular i përbashkët për t'u përdorur për kërkesat për kalim transit është bashkëngjitur në aneksin 6 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Shteti i kërkuar, brenda 5 ditëve kalendarike dhe me shkrim, njofton shtetin kërkuar për pranimin, duke konfirmuar vendin e hyrjes dhe kohën e parashikuar të pranimi, ose e njofton atë për mospranimin e kërkesës dhe për arsyet e këtij mospranimi.

3. Nëse kalimi tranzit bëhet në rrugë ajrore, personi që ripranohet dhe shoqëruesit e mundshëm shmanen nga detyrimi për të marrë vizë transiti aeroportual.

4. Autoritetet kompetente të shtetit të kërkuar ndihmojnë në operacionet e kalimit transit, pas konsultimeve reciproke, në veçanti, nëpërmjet mbikëqyrjes së personave në fjalë dhe masave të përshtatshme për këtë qëllim

SEKSIONI V

KOSTOT

Neni 15

Kostot e transportit dhe të transitit

Pa paragjykuar të drejtën e autoriteteve kompetente për të mbuluar kostot, lidhur me ripranimin, nga ana e personit që do të ripranohet apo nga palët e treta, të gjitha kostot e transportit, në lidhje me ripranimin dhe operacionet e kalimit transit në përputhje me këtë Marrëveshje deri në kufirin e shtetit të destinacionit përfundimtar, përballohen nga ana e shtetit kërkuar.

SEKSIONI VI

MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE KLAUZOLA E MOSNDIKIMIT

Neni 16

Mbrojtja e të dhënave

Komunikimi i të dhënave personale bëhet vetëm nëse është i nevojshëm për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nga autoritetet kompetente të Shqipërisë ose të një shteti anëtar sipas rastit. Përpunimi dhe trajtimi i të dhënave personale në një rast të veçantë janë subjekt i ligjeve të brendshme të Shqipërisë dhe, kur autoriteti kontrollues është autoritet kompetent i një shteti anëtar, do të jetë

subjekt i dispozitave të direktivës 95/46/EC³ dhe i legjislacionit të brendshëm të atij shteti anëtar të miratuar në përputhje me këtë direktivë. Gjithashtu do të zbatohen edhe parimet e mëposhtme:

- a) Të dhënat personale duhet të përpunohen në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme;
- b) Të dhënat personale duhet të mbledhen me qëllim specifik, të qartë dhe të ligjshëm për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe nuk duhet të përpunohen më tej nga autoriteti komunikues apo nga autoriteti marrës në një mënyrë që nuk përputhet me këtë qëllim;
- c) Të dhënat personale duhet të jenë të pranueshme, të vlefshme dhe të mos e tejkalojnë qëllimin për të cilin janë mbledhur dhe/ose përpunuar më tej; në veçanti, të dhënat personale që komunikohen të kenë të bëjnë vetëm me sa vijon:
 - të dhënat e veçanta të personit që do të transferohet (p.sh. emri, mbiemri, emra të mëparshëm, emra të tjerë të përdorur ose pseudonime, seksi, gjendja civile, data dhe vendi i lindjes, kombësia aktuale dhe e mëparshme);
 - pasaporta, karta e identitetit ose patentat (numri, periudha e vlefshmërisë, data e lëshimit, autoriteti që e ka lëshuar, vendi ku është lëshuar);
 - ndalesat dhe itineraret;
 - informacione të tjera të nevojshme për të identifikuar personin që do të transferohet ose për të shqyrtuar kërkesat e ripranimit në përputhje me këtë Marrëveshje.
- d) Të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe, aty ku është e mundur, të rifreskohen.
- e) Të dhënat personale duhet të ruhen në një formë që lejon identifikimin e subjektit të të dhënave për jo më shumë sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin këto të dhëna janë mbledhur ose për të cilin po përpunohen.
- f) Autoriteti komunikues dhe autoriteti marrës i të dhënave ndërmarrin çdo hap të arsyeshëm për të siguruar saktësimin e duhur, zhdukjen ose bllokimin e të dhënave personave në rastin kur komunikimi i tyre nuk përputhet me dispozitat e këtij neni, në veçanti nëse ato të dhëna nuk janë të përshtatshme, me vend, të sakta ose e tejkalojnë qëllimin për të cilin janë përpunuar. Kjo përfshin njoftimin e çdo korigjimi, zhdukjeje apo bllokimi nga pala tjetër.
- g) Mbi bazën e kërkesës, autoriteti marrës i të dhënave informon autoritetin komunikues mbi përdorimin e të dhënave të komunikuara dhe për rezultatet e përfituara prej tyre.
- h) Të dhënat personale mund t'u komunikohen vetëm autoriteteve kompetente. Komunikimi i mëtejshëm për organizma të tjerë kërkon pranimin paraprak të autoritetit komunikues.
- i) Autoritetet komunikuese dhe marrëse të të dhënave janë të detyruara të mbajnë procesverbal me shkrim për komunikimin dhe marrjen e të dhënave.

Neni 17

Klauzola e mosndikimit

1. Kjo Marrëveshje nuk do të cenojë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Komunitetit, shteteve anëtare dhe Shqipërisë që burojnë nga e drejta ndërkombëtare, veçanërisht nga Konventa Europiane e 4 nëntorit 1950 për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Konventa e 28 korrikut 1951 dhe protokollin e 31 janarit 1967 mbi statusin e refugjatëve dhe instrumentet ndërkombëtare mbi ekstradimin.

2. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk e ndalon kthimin e një personi sipas mënyrave të tjera formale apo informale.

SEKSIONI VII

REALIZIMI DHE ZBATIMI

³ Direktiva 95/46/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit më 24 tetor 1995 për mbrojtjen e individëve në lidhje me komunikimin e të dhënave personale dhe me lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave (OJ L 281 më 23.11.1995, fq.31). Direktiva e ndryshuar nga Rregullorja (EC) nr.1882/2003 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit. OJ L 284, 31.10.2003, fq.1).

Neni 18

Komisioni i përbashkët i ripranimit

1. Palët Kontraktuese i japin njëra-tjetres asistencë të ndërsjellë në zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim ato krijojnë një komision të përbashkët të ripranimit (në vijim “komisioni”), i cili do të ketë, në veçanti, detyrën:

- a) të kontrollojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;
 - b) të vendosë për masat e nevojshme për realizimin për zbatimin e njëtrajtshëm të kësaj Marrëveshjeje;
 - c) të ketë shkëmbime të rregullta informacioni mbi protokollet e zbatimit të hartuar nga shtete të veçanta anëtare dhe Shqipëria në përputhje me nenin 19;
 - d) të vendosë për amendamentet e anekseve të kësaj Marrëveshjeje;
 - e) të rekomandojë amendamentet e kësaj Marrëveshjeje.
2. Vendimet e komisionit janë të detyrueshme për Palët Kontraktuese.
3. Komisioni përbëhet nga përfaqësues të Komunitetit dhe Shqipërisë; Komuniteti përfaqësohet nga Komisioni Europian, i ndihmuar nga specialistë të shteteve anëtare.
4. Komisioni mbledhet sa herë që është e nevojshme me kërkesën e njëres nga Palët Kontraktuese.
5. Komisioni vendos rregulloren e brendshme.

Neni 19

Protokollet e zbatimit

1. Shqipëria dhe një shtet anëtar mund të hartojnë protokolle zbatimi të cilat do të përcaktojnë rregullat për:

- a) përcaktimin e autoriteteve kompetente, pikat e kalimit të kufirit dhe shkëmbimin e pikave të kontaktit;
- b) kushtet për kthimet e shoqëruara, përfshi transitin e shtetasve të vendeve të treta dhe të personave pa shtetësi të shoqëruar;
- c) mjete dhe dokumente shtesë veç atyre të listuara në anekset 1 deri 4 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Protokollet e zbatimit, në përputhje me paragrafin 1, do të hyjnë në fuqi vetëm pasi të jetë njoftuar Komisioni i Ripranimit, i përmendur në nenin 18.

3. Shqipëria pranon të zbatojë çdo dispozitë të ndonjë protokollit zbatimi të hartuar me një shtet anëtar gjithashtu dhe në marrëdhëniet e tij me çdo shtet tjetër anëtar me kërkesë të këtij të fundit.

Neni 20

Lidhja me marrëveshjet dypalëshe të ripranimit të shteteve anëtare

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje kanë përparësi ndaj dispozitave të çdo marrëveshjeje dypalëshe për ripranimin e personave që qëndrojnë pa leje të cilat janë përfunduar ose, sipas nenit 19, mund të përfundohen ndërmjet shteteve të veçanta anëtare dhe Shqipërisë.

SEKSIONI VIII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 21

Zbatimi territorial

1. Sipas paragrafit 2, kjo Marrëveshje zbatohet në territorin ku është i zbatueshëm Traktati Themelues i Komunitetit Europian dhe në territorin e Shqipërisë.

2. Kjo Marrëveshje nuk zbatohet në territorin e Mbretërisë së Danimarkës.

Neni 22

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe mbarimi

1. Kjo Marrëveshje ratifikohet apo miratohet nga Palët Kontraktuese në përputhje me procedurat e tyre përkatëse.

2. Sipas paragrafit 3, kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas datës kur Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën që procedurat e përcaktuara në paragrafin e parë janë përfunduar.

3. Nenet 3 dhe 5 të kësaj Marrëveshjeje hyjnë në fuqi 2 vjet pas datës së përmendur në paragrafin 2.

4. Kjo Marrëveshje lidhet për një kohë të pakufizuar.

5. Secila Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Marrëveshje duke njoftuar zyrtarisht Palën tjetër Kontraktuese. Kjo Marrëveshje nuk është më e zbatueshme gjashtë muaj pas datës së njoftimit.

Neni 23

Anekset

Anekset nga 1 deri në 6 janë një pjesë e pandarë e kësaj Marrëveshjeje.

Përgatitur më 14.4.2005, me kopje në gjuhët çeke, daneze, holandeze, angleze, estoneze, finlandeze, franceze, gjermane, greke, hungareze, italiane, letoneze, lituaneze, malteze, polake, portugeze, sllovake, slovene, spanjolle, suedeze dhe shqipe, secili nga këto tekste autentikisht i barasvlefshëm.

ANEKSI 1

LISTA E PËRBASHKËT E DOKUMENTEVE, PARAQITJA E TË CILAVE KONSIDEROHET SI PROVË SHTETËSIE (NENET 2 (1), 3 (1), 4 (1) DHE 5 (1))

- Pasaporta të çdo lloji (pasaporta të shteteve, pasaporta diplomatike, pasaporta shërbimi, pasaporta kolektive dhe pasaporta zëvendësuese, përfshi edhe pasaportat e fëmijëve);
- karta e identitetit, të çdo lloji (përfshi edhe kartat e përkohshme dhe provizore);
- librezë ushtarake dhe karta identiteti ushtarake;
- librezë marinarësh dhe karta shërbimi të kapitenëve të anijeve;
- certifikata shtetësie dhe dokumente të tjera zyrtare që përmendin apo tregojnë shtetësinë.

ANEKSI 2

LISTA E PËRBASHKËT E DOKUMENTEVE, PARAQITJA E TË CILAVE KONSIDEROHET SI PROVË NË DUKJE PËR SHTETËSINË (NENET 2 (1), 3 (1), 4 (1) DHE 5 (1))

- Fotokopje e secilit nga dokumentet e shënuara në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje;
- patenta ose fotokopje të tyre;
- certifikatat e lindjes ose fotokopjet e tyre;
- karta identiteti të kompanisë ose fotokopjet e tyre;
- dëshmi nga dëshmitarë;
- dëshmi të bëra nga personi në fjalë dhe gjuha e folur prej tij/saj, përfshi edhe përfundimet e një provimi zyrtar;
- çdo dokument tjetër që mund të ndihmojë për të përcaktuar shtetësinë e personit në fjalë.

ANEKSI 3

LISTA E PËRBASHKËT E DOKUMENTEVE, TË CILAT KONSIDEROHEN SI PROVË E KUSHTEVE PËR RIPRANIM TË SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA SHTETËSI (NENI 3 (1), NENI 5 (1))

- Vulat e hyrjes/daljes ose shënime të ngjashme në dokumentin e udhëtimit të personit në fjalë ose prova të tjera të hyrjes/daljes (p.sh. fotografike);

- dokumente, certifikata edhe fatura të çdo lloji (p.sh. fatura hoteli, konfirmime për trajtim mjekësor ose spitalor, dokumente hyrjeje për në institucione publike/private, marrëveshje për marrje makinash me qira, fatura të kartave të kreditit etj.) që tregojnë qartë që personi në fjalë ka qëndruar në territorin e shtetit të kërkuar;

- bileta dhe/ose lista pasagjerësh të udhëtimeve me avion, tren, autobus apo anije, të cilat tregojnë praninë dhe itinerarin e personit në fjalë në territorin e shtetit të kërkuar;

- informacion që tregon se personi në fjalë ka përdorur shërbimet e një agjencie transporti apo udhëtimesh;

- dëshmi zyrtare të lëshuara, në veçanti, nga pjesëtarë të personelit të autoriteteve kufitare dhe dëshmitarë të tjerë që mund të dëshmojnë për kalimin e kufirit nga ana e personit në fjalë;

- dëshmi zyrtare të bëra nga personi në fjalë në procedura gjyqësore apo administrative.

ANEKSI 4

LISTA E PËRBASHKËT E DOKUMENTEVE, QË KONSIDEROHEN SI PROVA NË DUKJE PËR KUSHTET E RIPRANIMIT TË SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA DHE TË PERSONAVE PA SHTETËSI (NENI 3 (1), NENI 5 (1))

- Përshkrim i vendit dhe rrethanave në të cilat personeli në fjalë është kapur pas hyrjes në territorin e shtetit kërkuar, lëshuar nga autoritetet përkatëse të atij shteti;

- informacion lidhur me identitetin dhe/ose qëndrimin e një personi lëshuar nga një organizatë ndërkombëtare;

- njoftim/konfirmim i informacionit nga pjesëtarët e familjes, shoqëruesit në udhëtim, etj.;

- dëshmi nga personi në fjalë.

ANEKSI 5



.....
.....
(Autoriteti që bën kërkesën)

.....
(Vendi dhe data)

Referuar:.....

Për

.....
.....
.....
(Autoritetit të cilit i bëhet kërkesa)

APLIKIM PËR RIPRANIM

Sipas nenit 7 të Marrëveshjes.....ndërmjet Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë për ripranimin e personave që qëndrojnë pa autorizim

A. TË DHËNA PERSONALE

1. Emri i plotë (mbiemri i nënvizuar)

.....

2. Emri i vajzërisë:

.....

3. Data dhe vendi i lindjes:

4. Emri i babait, emri i nënës:

Fotografia

Seksi dhe përshkrimi fizik (gjatësia, ngjyra e syve, shenja të veçanta etj.)

I njohur gjithashtu si (emra të mëparshëm, emra të tjerë të përdorur ose pseudonime):
Shtetësia dhe gjuha:

Gjendja civile: ☐ i martuar ☐ beqar ☐ i divorcuar ☐ i ve

Nëse është i martuar: emri i bashkëshortit/bashkëshortes.....

Emrat dhe mosha e fëmijëve (nëse ka).....

Adresa e fundit në shtetin që bën kërkesën

B. RRETHANA TË VEÇANTA NË LIDHJE ME TË TRANSFERUARIN

Gjendja shëndetësore

P.sh. sqarime të mundshme për trajtim të veçantë mjekësor, emri në latinisht i sëmundjes ngjitëse):

Shënime treguese për persona shumë të rrezikshëm:

(p.sh. i dyshuar për vepra penale të rënda, sjellje agresive):

C. PROVAT E BASHKËNGJITURA

1.....

(Nr. i pasaportës)

(autoriteti që e ka lëshuar)

.....

(data dhe vendi i lëshimit)

.....

(data e skadencës)

2.....

(Nr. i kartës së identitetit)

(autoriteti që e ka lëshuar)

.....

(data dhe vendi i lëshimit)

.....

(data e skadencës)

3.....

.....

(Nr.i patentës)	(data dhe vendi i lëshimit)
.....	
(autoriteti që e ka lëshuar)	(data e skadencës)
4.....	
(Nr. i dokumenteve të tjera zyrtare)	(data dhe vendi i lëshimit)
.....	
(autoriteti që e ka lëshuar)	(data e skadencës)

D. Vërejtje

.....

.....

.....

.....

.....

(Firma e autoritetit që bën kërkesën) (firma, vula)

ANEKSI 6



.....	
.....	(Vendi dhe data)
(Autoriteti që bën kërkesën)	

Referuar:.....

Për

.....

.....

.....

(Autoritetit të cilit i bëhet kërkesa)

APLIKIM PËR TRANSIT

1. Sipas nenit 13 të Marrëveshjes.....ndërmjet Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë për ripranimin e personave që qëndrojnë pa autorizim

A.TË DHËNA PERSONALE

1.Emri i plotë (mbiemri i nënvizur)

.....

2. Emri i vajzërisë

.....

3. Data dhe vendi i lindjes:

.....

4. Seksi dhe përshkrimi fizik (gjatësia, ngjyra e syve, shenja të veçanta etj.):

.....

5. I njohur gjithashtu si (emra të mëparshëm, emra të tjerë të përdorur ose pseudonime):

.....

6. Shtetësia dhe gjuha:

.....

7. Tipi dhe numri i dokumentit të udhëtimit:

.....

Fotografia

B. OPERACIONI I TRANSITIT

1. Tipi i tranzitit

☐ në rrugë ajrore

☐ në rrugë detare

☐ në rrugë tokësore

2. Shteti i destinacionit përfundimtar

.....

3. Shtete të tjera të mundshme për transit

.....

4. Pika e propozuar e kalimit të kufirit, data, koha e transferimit dhe shoqërimet e mundshme

.....

.....

.....

5. Pranimi i siguruar në çdo shtet tjetër transit edhe në shtetin e destinacionit përfundimtar (Neni 13 paragrafi 2).

☐ po

☐ jo

6. Të dhëna për çdo arsye për mospranimin e transitit (Neni 13 paragrafi 3)

☐ po

☐ jo

C. Vërejtje

.....
.....
.....

(Firma e autoritetit që bën kërkesën (firma/vula)

**DEKLARATË E PËRBASHKËT NË LIDHJE ME MARRËVESHJEN E ARDHSHME
TË STABILIZIMIT DHE ASOCIIMIT**

“Palët mbajnë parasysh se më 31 janar 2003 nisën negociatat mbi lidhjen e një marrëveshjeje stabilizimi dhe asociimi (MSA) ndërmjet Shqipërisë, nga njëra anë, dhe Komunitetit dhe vendeve anëtare të tij, nga ana tjetër, e cila do të përfshijë gjithashtu dispozita mbi parandalimin dhe kontrollin e emigrimit të paligjshëm dhe ripranimin.

Prandaj palët bien dakord që kjo Marrëveshje do të merret plotësisht në konsideratë në dispozitat përkatëse të MSA.”

DEKLARATË E PËRBASHKËT PËR NENIN 3

Palët mbajnë parasysh se detyrimi për ripranim ndaj shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi që disponojnë një vizë të vlefshme të lëshuar nga Shqipëria, (neni 3 (1) (a) i kësaj Marrëveshjeje) do të zbatohet vetëm nëse viza është përdorur për të hyrë në territorin e Shqipërisë”.

DEKLARATË E PËRBASHKËT PËR NENIN 18

“Takimi i Komisionit të Përbashkët të Ripranimit do të mbahet, kudo që është e mundur, paralelisht me nënkomisionin e ngritur në bazë të marrëveshjes së ardhshme të stabilizimit dhe asociimit.

Ai do të informojë këtë nënkomision për punën e tij.

Rregullorja e brendshme e Komisionit të Përbashkët të Ripranimit do të përputhet me rregullën e brendshme të këtij nënkomisioni.”

DEKLARATË E PËRBASHKËT PËR DANIMARKËN

“Palët Kontraktuese mbajnë parasysh se kjo Marrëveshje nuk gjen zbatim në territorin e Mbretërisë së Danimarkës dhe as mbi shtetasit e Mbretërisë së Danimarkës. Në rrethana të tilla është e përshtatshme që Shqipëria dhe Danimarka të lidhin një marrëveshje ripranimi në kushte të njëjta me këtë Marrëveshje.”

DEKLARATË E PËRBASHKËT MBI ISLANDËN DHE NORVEGJINË

“Palët Kontraktuese mbajnë parasysh marrëdhëniet e ngushta midis Komunitetit European dhe Islandës e Norvegjisë, veçanërisht mbështetur në Marrëveshjen e 18 majit 1999 mbi asociimin e këtyre vendeve me ekzekutimin, zbatimin dhe zhvillimin e *asquis* mbi Schengen. Në rrethana të tilla është e përshtatshme që Shqipëria të lidhë një marrëveshje ripranimi me Islandën dhe Norvegjinë në kushte të njëjta me këtë Marrëveshje.”